



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

D 7.1 – TOOLKIT PËRFUNDIMTAR

Era Sherifaj, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim





Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	HYRJE	3
2.	METODOLOGJIA	4
3.	TOOLKIT	5
3.1.	Paketa e Punës 1 (PP1): Menaxhimi dhe Koordinimi i Projektit	5
3.2.	Paketa e Punës 2 (PP2): Koncepti i Moduleve të Trajnimit	12
3.3.	Paketa e Punës 3 (PP3): Vizita Studimore për Lëvizhmëri	19
3.4.	Paketa e Punës 4 (PP4): Zhvillimi i Trajnimeve.....	22
3.5.	Paketa e Punës 5 (PP5): Evente të të Mësuarit në Bashkëpunim.....	26
3.6.	Paketa e Punës 6 (PP6): Komunikimi dhe Shpërndarja e Informacionit.....	34
3.7.	Paketa e Punës 7 (PP7): Toolkit, Rekomandime dhe Qëndrueshmëria	40
4.	PËRFUNDIMET	46
5.	ANEKS.....	47



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

1. HYRJE

Objektivi i përgjithshëm i projektit WISEs4Youth është të zhvillojë aktivitete trajnimi dhe lëvizshmërie për zhvillimin e aftësive sipërmarrëse sociale, me në fokus sipërmarrësit e rinj (potencialë) social në Ballkanin Perëndimor. Gjatë dy viteve të zbatimit të tij, projekti organizoi për përfituesit e tij aktivitete të tilla si vizita studimore, evente peer-to-peer, trajnime, një Toolkit me rezultatet përfundimtare dhe një udhërrëfyes mbi qëndrueshmërinë e sipërmarrjeve sociale.

Toolkit është një nga rezultatet kryesore të projektit, i cili ofron një përmbledhje të mësimëve të nxjerra gjatë zbatimit të tij, me synim arrijten e qëndrueshmërisë së rezultateve të projektit edhe pas përfundimit të periudhës së zbatimit. Ai shërben jo vetëm për qëndrueshmërinë e projektit, por edhe si një eksperiencë pilot që mund të motivojë aktorë të ndryshëm dhe të nxisë veprime të ngjashme për tema të ndryshme, në vende të tjera fqinje dhe të Bashkimit Evropian (BE).

Toolkit-i përfshin një përshkrim të shkurtër të secilës paketë pune, rezultatet e projektit dhe rekomandimet nga të gjithë partnerët. Bazuar në inputet dhe rekomandimet e partnerëve të projektit për secilën Paketë Pune (PP) që ata kanë udhëhequr, Toolkit është përgatitur si një mjet me rezultatet e projektit për qëndrueshmërinë dhe replikueshmërinë e sipërmarrjes në ekonominë sociale midis të rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe BE.

Qëllimi është të prezantohen rekomandimet dhe njohuritë e përfitura nga zbatimi praktik i detyrave të projektit brenda secilës Paketë Pune. Kjo përfshin ndarjen e strategjive të suksesshme, mjeteve dhe produkteve të prodhuara, si dhe të metodologjive të përdorura gjatë zbatimit për të arritur rezultate të suksesshme.

Synimi është të sigurohet jetëgjatësia e rezultateve të projektit duke fuqizuar sipërmarrësit e rinj potencialë socialë dhe aktorë të tjerë të mundshëm në ekonomisë sociale për të replikuar, përshtatur, adoptuar dhe zbatuar mjetet, strategjitë dhe rekomandimet nga ky projekt. Kjo përjasje lehtëson formulimin, zhvillimin dhe ekzekutimin e projekteve të suksesshme nga aktorë të tjerë potencialë jashtë fokusit të projektit dhe brenda një kuadri më të gjerë.



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

2. METODOLOGJIA

Toolkit-i është përgatitur në bashkëpunimin me partnerët e konsorciumit të projektit WISEs4Youth, ku secili prej tyre kontribuoi nëpërmjet Raporteve të Paketës së Punës (PP). Çdo raport i paketës së punës, i menaxhuar nga partnerët përkatës, ndjek një qasje të strukturuar të përgatitur nga Partnerët Shqipëri. Ai fillon me një përmbledhje të secilës paketë pune, duke detajuar partnerin udhëheqës, qëllimin e PP, periudhën e zbatimit, aktivitetet kryesore dhe rezultatet e arritura. Më pas, në seksionin e mjeteve, metodologjive dhe strategjive paraqiten metodologjitë, mjetet e përdorura dhe qasjet strategjike për zbatimin e secilës PP. Gjithashtu ofrohet informacion mbi funksionalitetin, aplikimin dhe burimet që kanë ndikuar në këto zgjedhje. Seksioni i fundit thellohet më tej në gjetjet kryesore dhe rekomandimet, duke theksuar arritjet, mësimet e nxjerra gjatë zbatimit, konsideratat kulturore dhe rekomandimet specifike për aktorët e interesuar dhe politikëbërësit. Kjo metodologji e ndjekur mundësoi përgatitjen e një Toolkit-i gjithëpërfshirës me informacion të vlefshëm për të nxitur iniciativa të suksesshme të sipërmarrjes sociale midis të rinjve.



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

3. TOOLKIT

3.1. Paketa e Punës 1 (PP1): Menaxhimi dhe Koordinimi i Projektit

Partneri udhëheqës i PP1: Rrjeti Evropian i Sipërmarrjeve të Integritit Social – ENSIE, Belgjikë

Periudha e zbatimit: Muaj 1 - Muaj 24 (Prill 2022 - Mars 2024)

Përmbledhje e PP1

PP1 fokusohet në sigurimin e zbatimit efektiv të aktiviteteve të menaxhimit, koordinimit dhe monitorimit të projektit. Kjo paketë përfshin organizimin dhe menaxhimin e takimeve të partnerëve të projektit (takim i parë i nisjes së projektit, takime online, transnacionale dhe në prezencë). PP1 përfshin gjithashtu detyrat e monitorimit dhe raportimit, si dhe ndjekjen e rregullt të zbatimit të projektit, zhvillimin e rezultateve dhe nevojat dhe kërkesat e përgjithshme administrative dhe financiare.

Ndërkohë aktivitetet kryesore përfshijnë organizimin e takimeve në prezencë dhe online për të ndjekur zbatimin efektiv dhe në kohë të projektit. Ato gjithashtu konsistojnë në koordinimin e partnerëve të projektit për të siguruar organizimin e aktiviteteve, dhe përgatitjen e produkteve (“deliverables”) në kohë dhe me cilësi.

Si **rezultate kryesore**, PP ofroi planin e menaxhimit të projektit dhe organizimin e takimit të parë për nisjen e projektit. Nëpërmjet kësaj pakete pune u menaxhua gjithashtu organizimi i takimeve (transnacionale) të projektit, organizimi i konferencës përfundimtare dhe përgatitja e raportit përfundimtar. Të gjitha produktet kontribuan në monitorimin e të gjithë procesit të zbatimit të projektit për të siguruar cilësinë e tij dhe impaktin e pritur.

Mjetet, Metodologjitë dhe Strategjitë

Të qenit koordinator i projektit nënkupton menaxhimin e zbatimit të PP-ve, marrëdhëniet me organet e BE-së, menaxhimin e buxhetit dhe koordinimin e takimeve me partnerët. Për secilin aktivitet, u aplikuan mjete dhe metodologji të ndryshme për zbatimin efektiv të projektit. Zakonisht, projektet përfshijnë partnerë nga vende të ndryshme, dhe është e rëndësishme që rezultatet dhe produktet të përdoren nga përfutuesit dhe të jenë të aksesueshme. Prandaj, përkthimi i tyre në gjuhët kombëtare të partnerëve është i rëndësishëm. Më poshtë është përshkrimi i mjeteve dhe metodave të përdorura për të



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

kryer punë cilësore kur bëhet fjalë për menaxhimin dhe koordinimin e projektit. Informacioni i mëposhtëm jepen bazuar në rezultatet kryesore të PP1 të projektit.

1. Plani i menaxhimit të projektit

Një plan cilësor i menaxhimit të projektit (PMP) është një mjet i rëndësishëm për menaxhimin e projektit në përgjithësi pasi vendos bazat për të gjithë projektin. Së pari duhet të prezantojë vetë projektin dhe kohëzgjatjen e tij, qëllimin dhe objektivat e tij, si dhe përbërjen e konsorciumit. Në të vërtetë, ai siguron një kuptim të qartë të asaj që synon të arrijë projekti, përcakton direktivat për ekipin e projektit dhe siguron që të gjithë të punojnë drejt të njëjtit qëllim. Përveç kësaj, mundëson një shpërndarje më të mirë të burimeve dhe ndihmon në identifikimin e burimeve të nevojshme për të përmbushur qëllimet e projektit, qofshin ato burime njerëzore, buxhet ose materiale.

Për më tepër, është e rëndësishme të përcaktohen përgjegjësitë dhe rolet e partnerëve të projektit pasi nxit një ndjenjë pronësie, llogaridhënieje dhe bashkëpunimi midis partnerëve të projektit, të cilat janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të çdo projekti. Për më tepër, pika e menaxhimit të riskut është vendimtare sepse mundëson identifikimin, vlerësimin dhe zbutjen proaktive të kërcënimeve të mundshme për suksesin e projektit.

Së fundi, një tjetër element është sigurimi i një plani të brendshëm komunikimi për projektin, i cili gjithashtu duhet të përfshihet në PMP. Ky plan siguron që komunikimi të jetë i qartë, në kohë dhe i përshtatur me nevojat e partnerëve.

2. Takimi i parë për nisjen e projektit

Organizimi i takimit të parë të një projekti (kick-off meeting) shërben si një pikënisje kritike për çdo projekt, duke hedhur bazat për menaxhimin efektiv të projektit, komunikimin, bashkëpunimin dhe suksesin. Ky takim ofron një mundësi për të vendosur të gjithë partnerët në të njëjtën linjë për qëllimin, objektivat dhe pritshmëritë e projektit, duke siguruar që të gjithë të kenë një ide të qartë se çfarë duhet të arrihet. Ai qartëson rolet dhe përgjegjësitë e partnerëve duke siguruar që të gjithë të kuptojnë kontributin e tyre në projekt, duke promovuar llogaridhënien. Për më tepër, në takim diskutohen afatet kohore të projektit, rezultatet, etapat 'milestones' etj., duke reduktuar mundësitë për keqkuptime ose konflikteve më vonë. Së fundi, takimi inkurajon bashkëpunimin dhe ndarjen e ideve duke u mundësuar pjesëmarrësve të kontribuojnë me ekspertizën, njohuritë dhe perspektivat e tyre në procesin e planifikimit të projektit.

Për të organizuar me sukses takimin e parë për nisjen e një projekti, përdoren disa mjete dhe metodologji si:



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

- Përdorimi i një agjende që përshkruan temat që do të diskutohen dhe ndarja e kësaj agjende me partnerët paraprakisht duke siguruar që ata të kenë mundësinë t'ë shtojnë pika shtesë nëse dëshirojnë.
- Aktivitete akullthyes (për shembull në “break out rooms” gjatë një takimi virtual) për të nxitur angazhimin e partnerëve veçanërisht nëse ata takohen për herë të parë.
- Përdorimi i pamjeve vizuale si “Power Point” për të ilustruar pikat kryesore. Ndhmon për të qartësuar informacionin kompleks dhe për t'i mbajtur pjesëmarrësit të angazhuar.
- Përdorimi i mjeteve komode të IT-së për takimin (Teams, Zoom, Webex etj.).
- Përgatitja e një mekanizmi reagimi për të mbledhur të dhëna dhe sugjerime nga partnerët në lidhje me formatin, përmbajtjen dhe efektivitetin e takimit të parë të projektit. Përmirësimi i vazhdueshëm është thelbësor për optimizimin e takimeve të ardhshme dhe rezultateve të projektit.

3. Takimet e partnerëve të projektit

Gjatë zhvillimit të takimeve të partnerëve brenda kornizës së projekteve, është thelbësore të përdoren mjete dhe metodologji që lehtësojnë komunikimin efikas, bashkëpunimin dhe menaxhimin e projekteve nëpër vende të ndryshme gjeografike. Këtu janë disa mjete dhe metodologji për t'u marrë parasysh dhe arsyetimet e tyre përkatëse:

- Platformat e softuerit të konferencave me video (p.sh. Zoom, Microsoft Teams, etj.): Këto mjete mundësojnë komunikimin ballë për ballë (online), duke nxitur një ndjenjë lidhjeje dhe angazhimi midis pjesëmarrësve, pavarësisht se janë të shpërndarë gjeografikisht. Konferencat me video mundësojnë diskutime, prezantime dhe sesione “brainstorming” në kohë reale, duke përmirësuar bashkëpunimin dhe vendimmarrjen.
- Platformat e menaxhimit të projekteve (si Teams, Share box, Google drive, Drop box etj.) të cilat lejojnë ndarjen e dokumenteve midis partnerëve janë të rëndësishme pasi ato lejojnë aksesin e partnerëve në dosje dhe mundësojnë bashkëpunimin në përgatitjen e rezultateve të projektit njëkohësisht dhe në kohë reale.



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

- Kur bëhet fjalë për takimet në prezencë të partnerëve të projektit (takime personalisht), është thelbësore të bashkëpunohet me partnerin mikëpritës për të siguruar që të ketë një sallë për takim, pajisje teknike etj. Përdorimi i e-maileve është thelbësor për të përcjellë informacionin mbi takimin dhe ofrimin e mjeteve dhe informacioneve të nevojshme (agjenda, linku i regjistrimit etj.).
- Ashtu si për takimet online, prezantimet vizuale dhe mekanizmat e komenteve dhe sugjerimeve janë thelbësore për arsyet e përmendura si më sipër.

4. Konferenca përfundimtare

Organizimi i një konference përfundimtare të suksesshme për një projekt kërkon planifikim të kujdesshëm, koordinim dhe komunikim efektiv. Mjetet dhe metodologjitë ndryshojnë nga një konferencë e organizuar në prezencë, online ose hibride. Në kuadër të projektit WISEs4Youth, formati i konferencës finale është hibrid, kështu që janë paraqitur mjetet dhe metodologjitë për këtë format.

- Para së gjithash, është e rëndësishme të vendoset në dakordësi për një datë që do t'i përshtatet të gjithë partnerëve. Mund të zhvillohet një Doodle ose një takim për të planifikuar ditën dhe orarin e konferencës.
- Kur zgjidhni një sallë konferencash/takimesh, mundësisht konsultohuni me katalogët e ndërtesave të përgjegjshme eko-socio dhe të kontrolloni nëse mund të sigurohen të gjitha pajisjet teknike si dhe mbështetja teknike. Duhet të keni parasysh gjithashtu ofrimin e kateringut gjatë eventit (pushime kafeje, pushime dreke etj.).
- Si hap tjetër, është e rëndësishme identifikimi dhe kontaktimi me folësit përkatës për konferencën dhe përgatitja e një agjende/koncept për takimin. Kontaktimi bëhet zakonisht me e-mail ose telefon dhe për përgatitjen e agjendës zakonisht përdoret Microsoft Word.
- Për një organizim të suksesshëm, është e rëndësishme t'ju ofrohet folësve informacion mbi sesionin dhe kontekstin e takimit si dhe agjendën. Për këtë qëllim, zhvillimi i takimeve ballë për ballë me folësit përpara eventit (nëpërmjet Teams, Zoom, telefonatave, Webex etj.) është thelbësore për të qartësuar pritshmëritë nga ndërhyrjet e tyre dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre të mundshme. Mund të ofrohen edhe udhëzime për të mbështetur folësit në përgatitjen e tyre.



Projekti: 101049682 — WISes4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

- Është e rëndësishme të krijoni një link regjistrimi për të menaxhuar numrin e pjesëmarrësve duke përdorur platforma online si Google Forms, Survey Monkey etj.
- Gjithashtu, duhet të krijohet një link për të organizuar dhe menaxhuar takimin online dhe pjesëmarrësit virtualë përmes softuerëve si Zoom, Teams, Webex etj.
- Për sa i përket komunikimit mbi eventin, është e rëndësishme të krijohet një fletëpalosje/broshurë (nëpërmjet Canva, Word etj.) dhe ta shpërndani atë në mediat sociale (LinkedIn, Facebook, X, Instagram etj.), në webfaqet zyrtare të partnerëve përkatës të projektit si dhe në kanale të tjera komunikimi.
- Material promovues mund të përgatitet gjithashtu për të promovuar projektin (çanta, gota, stilolaps, broshurë e projektit etj). Është e rëndësishme të bëni porosinë paraprakisht për t'u siguruar që ajo të dorëzohet në kohë.
- Gjatë vetë konferencës, është e rëndësishme të përdoren mjete ndërvepruese me pjesëmarrësit për të tërhequr dhe mbajtur vëmendjen e tyre. Ndër mjetet mund të përdoret Mentimeter , Jamboard , Slido etj.
- Përdorimi i prezantimeve në Power Point është gjithashtu i mirëpritur gjatë sesionit pasi audienca zakonisht ndjek lehtësisht një sesion me mbështetje vizuale dhe përveç kësaj, pjesëmarrësit zakonisht dëshirojnë t'i marrin prezantimet pas sesionit.
- Së fundi, nga ana praktike, është e rëndësishme të përgatiten listë prezencat që do të nënshkruhen nga të pranishmit, si dhe formularët e vlerësimit për të pasur komente për eventin, me qëllim përmirësimin e seancave të tilla në të ardhmen.
- Si përfundim, pas sesionit është e rëndësishme të hartoni një përmbledhje nga konferenca përfundimtare dhe ta shpërndani atë online (në mediat sociale dhe faqet e internetit të projektit) ose nëpërmjet buletineve informuese, gjithashtu analizoni formularët e vlerësimit dhe komunikoni me folësit për t'i falënderuar ata për ndërhyrjen dhe pjesëmarrjen e tyre.

5. Raporti përfundimtar

Përgatitja e një raporti përfundimtar për një projekt përfshin përmbledhjen dhe paraqitjen e gjetjeve, rezultateve dhe rekomandimeve kryesore në një dokument gjithëpërfshirës. Si



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

më poshtë metodologjitë dhe mjetet që duhen marrë në konsideratë për hartimin e një raporti përfundimtar efektiv:

- Përdorni një kornizë ose format të strukturuar për të përgatitur raportin përfundimtar. Ky raport mund të përfshijë seksione të tilla si Përmbledhja Ekzekutive, Hyrje, Objektivat, Metodologjia, Gjetjet, Përfundimet, Rekomandimet dhe Shtojcat. Një format i strukturuar i ndihmon lexuesit të lexojnë dhe të kuptojnë përmbajtjen e tij lehtësisht.
- Përdorni mjete të ndryshme për të mbledhur dhe analizuar të dhënat e projektit, të tilla si anketat, intervistat, procesverbalet dhe rishikimet e dokumenteve. Mjetet si SurveyMonkey, Google Forms ose Microsoft Excel lehtësojnë mbledhjen, organizimin dhe analizën e të dhënave, duke mundësuar përfundime dhe rekomandime të bazuara në fakte.
- Përdorni platforma bashkëpunuese për dokumentat si Google Drive, Microsoft SharePoint ose Dropbox Paper për të lehtësuar bashkëpunimin dhe redaktimin e përbashkët të raportit përfundimtar.
- Përdorni mjete të ndryshme për shkrimin dhe redaktimin për të siguruar qartësi, konsistencë dhe profesionalizëm në raportin përfundimtar. Kjo mund të përfshijë softuer për përpunimin e tekstit si Microsoft Word, dhe softuer si Grammarly për kontrollin e stilit të shkrimit dhe gramatikës.
- Angazhoni dhe përfshini palët kryesore të interesuara në rishikimin dhe vërtetimin e raportit përfundimtar për të siguruar saktësinë, rëndësinë dhe përafrimin me objektivat e projektit. Kërkoni komente nga partnerët e projektit për të përmirësuar cilësinë dhe besueshmërinë e raportit.

Gjetjet Kryesore dhe Rekomandimet

Gjetjet kryesore nga procesi i zbatimit dhe rekomandimet për zbatimin cilësor të detyrave:

- Kohezioni i partnerëve të projektit ndikon në cilësinë e zbatimit të projektit. Ndaj, është e rëndësishme të mbështeten partnerë gjatë fazës së zbatimit, të koordinohen takimet dhe komunikimi ndërmjet partnerëve për të siguruar shpërndarjen në kohë dhe cilësore të rezultateve të projektit.
- Përdorni mjetet e disponueshme të teknologjisë së informacionit për të lehtësuar bashkëpunimin dhe për të siguruar zbatimin cilësor të projektit. Në të



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO


vërtetë, takimet e projektit ishin një metodë thelbësore për të kapërcyer komplikimet dhe për të siguruar një kuptim të mirë të hapave që duheshin ndjekur nga secili partner për zbatimin cilësor të projektit.

- Fleksibiliteti, disponueshmëria dhe përgjegjshmëria e partnerëve është thelbësore për zbatimin në kohë të detyrave.

Rekomandime politikash për të mbështetur sipërmarrjen sociale të të rinjve:

Sipas rezultateve të anketës së pjesëmarrësve [të Akademisë së Politikave të Sipërmarrjeve Rinore](#),¹ të organizuar në vitin 2023, sfidat kryesore me të cilat përballen sipërmarrësit e rinj socialë janë si më poshtë në figurë:

Sfidat kryesore me të cilat përballen të rinjtë sipërmarrës



Për të trajtuar këto sfida, është e rëndësishme t'u ofrohet sipërmarrësve të rinj një numër i ndryshëm instrumentash financiare, të zhvillohen aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të

¹ Akademia e Politikave e Sipërmarrjeve Rinore (YEPA) është një rrjet prej 150 pjesëmarrësish i fokusuar në ofrimin e informacionit dhe mësimin e politikave, duke përfshirë politikëbërës, rrjete dhe organizata të sipërmarrjes rinore, rrjete të sipërmarrjes sociale, menaxherë programesh dhe studiues. YEPA synon të forcojë politikën dhe programet e sipërmarrjes rinore duke rritur njohuritë mbi barrierat me të cilat përballen të rinjtë në sipërmarrje dhe lehtëson shkëmbimet midis politikëbërësve, sipërmarrësve të rinj dhe ekspertëve mbi "çfarë funksionon" në politikën e sipërmarrjeve rinore.



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

të rinjve mbi ndërtimin dhe drejtimin e sipërmarrjeve sociale, të krijohen forma ligjore, statute dhe etiket ose 'labels' në veçanti për sipërmarrjet sociale, të punohet për matjen e impaktit, të mbështeten të rinjtë në zhvillimin e aftësive të biznesit dhe të ofrohen plane veprimi/strategji për sipërmarrjen sociale.

Është me të vërtetë e rëndësishme të integrohet edukimi për sipërmarrjen në kurrikulat formale të shkollave që në moshë të hershme, duke u mësuar nxënësve për planifikimin e biznesit, edukimin financiar, zgjidhjen e problemeve dhe impaktin social.

Për më tepër, është thelbësore të inkurajohen partneritetet midis sipërmarrjeve sociale të rinjve dhe korporatave më të mëdha, agjencive qeveritare dhe organizatave jo qeveritare (OJQ) për të krijuar mundësi për bashkëpunim, inovacion dhe përfitim reciprok.

Përveç kësaj, është e rëndësishme të zhvillohen korniza dhe mjete të standardizuara për matjen e impaktit të përshtatura për sipërmarrjet sociale të rinjve, duke u mundësuar atyre të gjurmojnë, vlerësojnë dhe komunikojnë në mënyrë efektive impaktin e tyre social dhe mjedisor. Së fundi, Shtetet Anëtare duhet të zhvillojnë/përditësojnë strategjitë e tyre kombëtare për zhvillimin dhe mbështetjen e ekonomisë sociale siç rekomandohet në [Planin e Veprimit për Ekonominë Sociale](#) si dhe të zbatojnë sa më shpejt të jetë e mundur [Rekomandimet e Këshillit për zhvillimin e kushteve të kornizës së ekonomisë sociale](#).

3.2. Paketa e Punës 2 (PP2): Koncepti i Moduleve të Trajnimit

Partneri udhëheqës i PP2: ACT Group – AG, Kroaci

Periudha e zbatimit: Muaj 3 - Muaj 8 (Qershor 2022 - Shtator 2022)

Përmbledhje e PP2

Qëllimi i PP2 ishte zhvillimi i një kurrikule me materiale trajnimi (pjesa teorike dhe praktike) dhe përcaktimi i përmbajtjes së trajnimit me qëllim fuqizimin e përfaqësuesve të partnerëve të projektit W4Y, në mënyrë që ata të mund të jenë më pas trajnerë për të rinjtë në vendet e tyre. Kurrikula u përgatit për dy tema kryesore:

1. Menaxhimi i Sipërmarrjeve sociale dhe Sipërmarrjeve Sociale me në fokus Integrimin në punë (WISE);
2. SIMM (Matje dhe menaxhimi i Impaktit social).



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

Nëpërmjet pilotimit dhe zbatimit të kurrikulave të përmendura në paketat e mëvonshme të punës të WISEs4Youth, përfaqësuesit e partnerëve të projektit përveçësuar njohuritë që ata duhej t'u transferonin përdoruesve të drejtpërdrejtë (duke synuar përfaqësuesit dhe sipërmarrësit e rinj (potencialë) të WISEs) në secilin prej vendeve të tyre. Këto njohuri, të përshtatura për përfaqësuesit e rinj të WISE-ve, synonin të rrisin gatishmërinë dhe përgatitjen e tyre për të vepruar si lehtësues dhe advokues të sipërmarrjeve WISE në kontekstet e tyre lokale.

Aktivitetet kryesore përfshinin zhvillimin e moduleve të trajnimit dhe koordinimin e zhvillimit të moduleve me partnerët.

PP2 prodhoi **tre produkte kryesore**; një Kurrikulë (për trajnimin e partnerëve) për Menaxhimin e Sipërmarrjeve Sociale dhe WISE-eve, e cila është zhvilluar me mbështetjen e partnerit slloven SENT, një kurrikulë për matjen dhe menaxhimin e impaktit dhe një raport për zhvillimin e moduleve të trajnimit. Të gjitha produktet 'deliverables' janë përgatitur në gjuhën angleze dhe janë të aksesueshme përmes mjeteve online, duke siguruar që partnerët e projektit dhe audienca e synuar, veçanërisht të rinjtë, mund t'i përdorin lehtësisht ato.

Të gjitha materialet janë përgatitur në anglisht dhe janë të disponueshme përmes mjeteve online për t'i përdorur partnerët dhe të rinjtë.

Rezultatet kryesore të PP2 janë zhvillimi i dy kurrikulave së bashku me materialet përkatëse të trajnimit që janë përdorur për testimin pilot gjatë aktiviteteve trajnuese si pjesë e PP4, në secilin prej vendeve partnere. Për më tepër, gjatë hartimit të kurrikulave në bashkëpunim, partnerët zgjeruan njohuritë e tyre si për procesin e krijimit ashtu edhe për temat specifike të mbuluara në kurrikulë.

Mjetet, Metodologjitë dhe Strategjitë

Për të zhvilluar kurrikulat (dhe të gjitha materialet shoqëruese) **procesi i mëposhtëm i bashkëkrijimit** mund të përdoret për përgatitjen e programeve përkatëse të kurrikulave:

- Hartimi i përfaqësuesit që do ndiqet dhe strukturës së parë të Kurrikulës me pjesëmarrjen e partnerëve përgjegjës
- Ndarja e strukturës së kurrikulës dhe përmbajtjes së draftit me partnerin kryesor dhe partnerët e përfshirë
- Përditësimi i kurrikulës (strukturës dhe përmbajtjes) bazuar në komentet e para të partnerit drejtues



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

- Prezantimi dhe shpërndarja e kurrikulave për të gjithë partnerët për rishikim/komentim/feedback
- Finalizimi i kurrikulave dhe materialeve dhe dorëzimi e kurrikulave brenda afatit kohor të specifikuar dhe në platformat e dakorduara
- Pas finalizimit dhe dorëzimit të kurrikulave, përgatitja e një Raporti për zhvillimin e moduleve të trajnimit është një element i rëndësishëm për të kuptuar më mirë procesin e ndjekur.

Gjatë procesit të bashkë-krijimit, aktivitetet/takimet kryesore të mëposhtme mund të jenë të dobishme:

- Pjesëmarrja në takimin e parë për nisjen e projektit (kick-off meeting), ku të gjithë partnerët janë të pranishëm, ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjithë projektit. Ky angazhim lejon një kuptim më të mirë të kontekstit të projektit, komponentëve specifikë dhe Paketave të Punës (PP). Brenda këtij sesi, bëhet një prezantim i thelluar i të gjithë projektit, me një theks të veçantë në PP-në të cilën udhëhiqni, duke siguruar që të gjithë partnerët pjesëmarrës të jenë të mirëinformuar.
Për më tepër, ky takim shërben si një platformë për diskutime domethënëse që synojnë vendosjen e afateve të qarta për rezultatet e projektit. Ai krijon një mundësi për të adresuar çështjet ose pyetjet e mundshme që lidhen me çdo PP, duke nxitur një mjedis bashkëpunues për zgjidhjen e problemeve. Për më tepër, takimi ofron një hapësirë strategjike për të arritur marrëveshje për hapat pasues dhe fazën e përgatitjes për hartimin e dokumenteve, në këtë rast të kurrikulave, ose detyrave brenda PP-ve që ju udhëhiqni.
- Zhvillimi i takimeve të para online ndërmjet partnerëve kryesorë të caktuar si përgjegjës për zbatimin e PP-së është i nevojshëm për fillimin e diskutimeve të fokusuar mbi përfaqshjen për hartimin e kurrikulave ose dokumentave përkatës. Qëllimi i këtyre sesioneve është të rafinojnë dhe sinkronizojnë mirëkuptimin e të dy partnerëve në lidhje me procesin e përgjithshëm dhe përfaqshjen ndaj Paketës së Punës (PP) përkatëse.
- Angazhimi në takime online ndërmjet partnerëve përgjegjës dhe partnerit kryesor ka rëndësi në diskutimin e strukturës dhe përmbajtjes së kurrikulave, duke vlerësuar përputhshmërinë e tyre me përshkrimet e propozimeve në projekt. Është



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

thelbësore të përcaktohen veprimet specifike dhe hapat konkretë për hartimin e draftit fillestar dhe të vendosen afate për fazat e mëvonshme të zhvillimit.

- Zhvillimi i takimeve online ndërmjet partnerëve përgjegjës dhe partnerit udhëheqës për të kontrolluar ecurinë e punës është thelbësor për ndjekjen dhe vlerësimin e vazhdueshëm të produkteve të zhvilluara. Në një përpjekje bashkëpunuese, partnerët marrin pjesë në rishikimin e hollësishëm të dokumenteve për të identifikuar përmirësimet e nevojshme në kurrikulat e hartuara. Përveç kësaj, ky sesion ofron një mundësi për të rënë dakord reciprokisht për afatet për përfundimin e versioneve të plota finale, gati për prezantim dhe komente nga partnerët e tjerë të projektit.
- Një takim final online që përfshin të gjithë partnerët e projektit është thelbësor për një prezantim gjithëpërfshirës të kurrikulave të përgatitura. Secili partner i përfshirë në përgatitjen e kurrikulës ndan informacion mbi punën dhe kontributet e tyre përkatëse. Ky takim përfshin edhe diskutime në lidhje me çështjet apo pyetjet e mundshme në lidhje me kurrikulat, me qëllim të mbledhjes së komenteve fillestare nga të gjithë partnerët pjesëmarrës.
- Partnerëve të projektit duhet t'u vendoset në dispozicion një kohë e konsiderueshme për të rishikuar dhe për të ofruar komentet e tyre për versionet përfundimtare të kurrikulave. Pas shqyrtimit dhe reflektimit të njohurive të tyre, kurrikulat e përfunduara mund të dorëzohen.

Është e rëndësishme të theksohet se krijimi i kurrikulave duhet të bëhet në një proces bashkë-krijues, partnerët kryesorë krijojnë strukturën bazë dhe draftin e përmbajtjes, ndërsa partnerët e tjerë përfshihen duke dhënë komente dhe sugjerime për shtesa/ndryshime.

Në procesin e zhvillimit të kurrikulave, mund të mbështeteni kryesisht në njohuritë dhe eksperiencën mëparshme të partnerëve të projektit që rezultojnë nga aktivitete të ngjashme në zhvillimin e materialeve edukative dhe kurrikulave. Përveç kësaj, burime tematike të jashtme (kryesisht të disponueshme në internet) mund të përdoren për të përgatitur përmbajtjen.

Koordinimi dhe komunikimi rreth zhvillimit të kurrikulës duhet të bëhet në një mjedis online - nëpërmjet postës elektronike (e-mail), takimeve online dhe mjeteve të bashkëpunimit (Office 365, MS SharePoint...).



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

Një ndarje e tillë e rënë dakord e roleve (partnerët kryesorë – përgatitja e strukturës dhe përmbajtjes bazë, ndërsa partnerët e tjerë - rishikimi dhe komentimi/sugjerimet) dhe përdorimi i mjedisit online (mjetet digjitale) ndihmojnë për të qenë operacional dhe për të kryer aktivitete brenda afateve të përcaktuara në projekt.

Gjetjet Kryesore dhe Rekomandimet

Gjeni më poshtë disa nga gjetjet kryesore dhe mësimet e mbledhura/konfirmuara përmes zhvillimit të kurrikulës dhe zbatimit të PP2 për t'u ndjekur ose përsëritur për realizimin e suksesshëm të detyrave të natyrës të ngjashme:

- të keni një kuptim 'background' të mirë analitik për temën që do t'ju mundësojë të identifikoni më mirë qëllimin kryesor të kurrikulës suaj, grupet e synuara të përdoruesve dhe nevojat dhe sfidat e tyre. Kjo është shumë e rëndësishme sepse ka një tendencë në rritje që arsimit/trajnimi të jetë i synuar/specifik, më i shkurtër, me shumë shembuj nga praktika;
- është shumë e rëndësishme që të përcaktoni qartë se kush është grupi i synuar të cilit i drjetohej kurrikula (kush janë edukatorët si dhe përdoruesit përfundimtarë - pjesëmarrësit në trajnime). Kjo do t'ju ndihmojë të përqendroni punën në përmbajtje dhe tema specifike (veçanërisht për tema që janë aq të gjera sa menaxhimi i WISE etj.), ose të përcaktoni nivele të ndryshme të kompleksitetit të përmbajtjes (p.sh. bazë, të avancuara, etj.). Kjo gjithashtu mund t'ju ndihmojë të zgjidhni më qartë pjesëmarrësit e mundshëm të trajnimeve ose të përshtatni trajnimin sipas nevojave të përdoruesve;
- për hir të praktikitetit dhe funksionalitetit të proceseve të tilla të zhvillimit të kurrikulave (materiale, botime, etj.), është praktike që ekipi kryesor (ekspertët) të përgatisin strukturën dhe të paktën versionin e parë të përmbajtjes/materialit, të cilat më pas duhet të jenë subjekt i komenteve dhe ndryshimeve nga të gjithë/përfaqësuesit e partnerëve të tjerë;
- të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe konkrete etapat 'milestones', afatet dhe rolet (veçanërisht duke marrë parasysh ekspertizën specifike);
- procesi nuk duhet të zgjasë shumë - përdorni një përfaqesje të thjeshtë, ndërtoni versionin e parë të kurrikulave dhe materialeve dhe testoni sa më shpejt që të jetë e mundur;



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

- temat duhet të trajtohen teorikisht (të qarta dhe koncize, leksione/prezantime jo shumë të gjata) dhe praktikisht (shumë shembuj të mirë, ushtrime praktike, punë në grup, reflektime personale, shkëmbim njohurish/përvoja, duke nënvizuar pikat kryesore për tu mësuar...). Pjesa e praktikës duhet të jetë e barabartë ose edhe më e madhe se ajo teorike;
- Krahas Kurrikulave, duhet të zhvillohen materiale/manualë që t'u shpjegojnë mjaftueshëm trajnerëve të ardhshëm se si t'i qasen trajnimit metodologjikisht dhe në përmbajtje në bazë të kurrikulës së zhvilluar. Materialet/manualët duhet të përmbajnë gjithashtu një listë të literaturës/burimeve që mund të thellojnë njohuritë për temën e dhënë;
- të përcaktojë gjithashtu mënyrat për të kontrolluar nëse janë arritur rezultatet e dëshiruara të të nxënit (qasja cilësore dhe sasiore);
- përdorimi i teknologjive digjitale gjithashtu kontribuon në funksionueshmërinë dhe praktikitetin;
- përdorni qasjen paralele të të menduarit për atë që do zhvillohet më pas “paralel forward thinking approach” - zhvilloni kurrikulat dhe materialet duke pasur në vëmendje trajnimin që do të zhvillohet në bazë të asaj kurrikule, që do t'ju detyrojë të përqendroheni dhe të mendoni për gjëra praktike;
- rishikoni, përditësoni metodologjinë dhe përmbajtjen e kurrikulave tuaja pas testimit pilot;
- duhet lënë pak hapësirë për specifikat e secilit shtet në nivel lokal.

Rekomandime për politikëbërësit se cilat masa mbështetëse nevojiten për të mbështetur sipërmarrjet sociale (të të rinjve):

- të ofrohet edukim mbi sipërmarrjen sociale/WISEs (workshope, trajnime, mentorime, vizita studimore);
- hartëzimi dhe përditësim i rregullt i databazës unike të aktorëve të sipërmarrjes sociale në nivel kombëtar;
- të ofrohen fonde për kërkime të vazhdueshme mbi sipërmarrjen sociale dhe WISE;



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

- të forcohet bashkëpunimi midis aktorëve të ndryshëm në fushën e sipërmarrjes sociale/WISEs;
- të punohet në mënyrë aktive për kuadrin legjislativ në lidhje me sipërmarrjen sociale/WISE në nivel kombëtar;
- të përcaktohen institucionet përgjegjëse për zhvillimin e sipërmarrjes sociale në nivel kombëtar;
- të përfshihet dhe zbatohet tema e sipërmarrjes sociale në strategjitë dhe programet lokale/rajonale;
- të zhvillohen tenderë të hapur për popullarizimin e sipërmarrjes sociale me theks të veçantë në sektorin privat dhe publik me të cilin bëjnë biznes sipërmarrjet sociale, me kriterë të qarta për alokimin e fondeve;
- të krijohet një instrumenti financiar të specializuar për sipërmarrjet sociale, p.sh. një fond për bashkëfinancimin e projekteve nga fondet e BE-së, një fond për bashkëfinancimin e punësimeve të reja në sipërmarrjet sociale;
- të edukohen autoritetet publike kontraktore për prokurimin me përgjegjësi sociale, zhvillimin e mjeteve për zbatim efektiv, të hapura, dhe afrimin e proceseve të prokurimit publik me aktorët e sipërmarrjes sociale;
- të përmirësohet marketingu, të promovohet 'cross selling' si strategji shitje së dhe të rritet vizibiliteti i sipërmarrjeve sociale përmes panairëve, eventeve dhe aktiviteteve të ngjashme;
- të punohet vazhdimisht në promovimin e prokurimit publik të qëndrueshëm;
- të krijohen qendra të specializuara 'one stop shop' për zhvillimin e sipërmarrjes sociale, qendra mbështetëse për zhvillimin e sipërmarrjes sociale/WISEs;
- të zhvillohen programe të mbështetjes, inkubacionit dhe përsheptimit off-line dhe on-line për të mbështetur sipërmarrjet ekzistuese sociale/WISE që kanë potencial për rritje dhe zhvillim;
- të zhvillohen dhe financohen skema mentorimi për sipërmarrjet sociale;



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

- të inkorporohet matja e impaktit social në proceset e prokurimit publik, financimit/tenderëve etj.

3.3. Paketa e Punës 3 (PP3): Vizita Studimore për Lëvizhmëri

Partneri udhëheqës i PP3: Shoqata e Qytetarëve Iniciativa për Zhvillim dhe Bashkëpunim – IDC, Serbi

Periudha e zbatimit: Muaj 10 – Muaj 14 (Qershor 2023 – Dhjetor 2023)

Përmbledhje e PP3

PP3 në projektin WISEs4Youth synonte promovimin e lëvizshmërisë së sipërmarrësve të rinj potencialë socialë si dhe të shërbej si komponent plotësues i programit të trajnimit në të cilin të rinjtë ishin pjesëmarrës, nëpërmjet shembujve praktikë të WISE-ve të suksesshme.

Aktivitetet kryesore të kësaj pakete pune konsistojnë në 5 vizita studimore të organizuara në vendet përkatëse të partnerëve të projektit sipas këtij rendi: Shqipëri, Serbi, Kroaci, Maqedoni e Veriut dhe Slloveni. Për më tepër, gjatë këtyre vizitave partnerët shfrytëzuan mundësinë për të pasur një takim projekti për të shkëmbyer dhe për të diskutuar mbi zbatimin e mëtejshëm të projektit. Përveç kësaj, për të siguruar një zbatim efikas të vizitave studimore, IDC zhvilloi një plan vizitash studimore i cili përfshin një përshkrim të shkurtër të çdo vizite bazuar në informacionin e ofruar nga të gjithë partnerët. Në fund, u përgatit një pyetësor vlerësimi mbi vizitat studimore, në të cilin u përfshin sugjerimet dhe komentet e rishikua edhe nga partnerët. I njëjti pyetësor është përdorur në secilën prej vizitave studimore.

Rezultatet e vizitave studimore tregojnë se 63 pjesëmarrës gjithësej nga 5 vende partnere morën pjesë në vizitat studimore, ndër të cilat 54 ishin të rinj dhe 9 përfaqësues të stafit të partnerëve. Midis 54 pjesëmarrësve të rinj, disa pjesëmarrës të njëjtë morën pjesë në vizita studimore në disa vende partnere dhe kryesisht të njëjtët anëtarë të stafit të partnerëve morën pjesë në çdo vizitë studimore. Përveç kësaj, të gjithë partnerët u angazhuan të respektojnë balancën gjinore të pjesëmarrësve në vizitat studimore. Sipas rezultateve midis 63 pjesëmarrësve, 30 ishin burra dhe 33 gra. Në përgjithësi, 83 formularë vlerësimi u mbledhën nga të gjitha vizitat studimore.



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

Si pjesë e kësaj pakete pune u përgatitën një raport përfundimtar mbi vizitat studimore dhe një dokument përmbledhës i praktikave të mira të ekonomisë sociale në BB, i cili ofron një prezantim të sipërmarrjeve të vizituara në kuadër të projektit, si një portofol i praktikave më të mira, të cilat njëkohësisht përputhem dhe me përmbajtjen e moduleve të trajnimit.

Mjetet, Metodologjitë dhe Strategjitë

Gjeni më poshtë mjetet, strategjitë dhe metodat që duhen përdorur gjatë organizimit të vizitave studimore. Informacionet e ofruara më poshtë bazohen në zbatimin e PP3.

Të përdoret agjenda, duke përfshirë në të detajet e itinerarit, oraret e sakta, vendndodhjen e takimit, periudhat e përcaktuara të pushimit dhe oraret e detajuara të vizitave me vendndodhjen e saktë për secilin prej vendeve. Agjenda shërben si një udhërrëfyes, duke siguruar një koordinim të mirë dhe duke maksimizuar efikasitetin e përvojave të vizitave studimore.

Përgatitja e një Udhëzues mbi Udhëtimin dhe një Plan të Vizitave Studimore është e rëndësishme për tu ofruar pjesëmarrësve informacionin dhe burimet thelbësore për të siguruar një udhëtim të qetë dhe të sigurt. Ai përfshin informacion në lidhje me qëllimin e vizitave studimore, detajet e itinerarit, duke përfshirë datat, oraret, vendndodhjet, aktivitetet e planifikuara, takimet dhe vizitat në terren. Gjithashtu, ai përfshin informacionin e akomodimit, detajet e transportit, takimet e planifikuara dhe detajet e eventeve, kontaktet e urgjencës, informacionin kulturor dhe praktik, hartat dhe lokacionin e vendeve të rëndësishme si hotelet, restorantet dhe atraksionet.

Gjithashtu është e nevojshme të përdoren listat e prezencës, për të regjistruar pjesëmarrësit, për ti ruajtur si të dhëna, dhe për të lehtësuar komunikimin me pjesëmarrësit para, gjatë dhe pas një aktiviteti.

Duhet të përgatiten pyetësorë për të vlerësuar e vizitat studimore. Google Forms, Survey Monkey, ose pyetësorët e zakonshëm të printuar në fletë janë disa nga mjetet e anketimit që duhen përdorur për të mbledhur komente nga pjesëmarrësit pas vizitave studimore. Kjo i lejon organizatorët të vlerësojnë pritshmëritë, preferencat dhe kënaqësinë e përgjithshme të pjesëmarrësve, duke ndihmuar në përmirësimin e organizimeve të vizitave studimore të ardhshme.

Platforma komunikimi si e-maili, aplikacionet e mesazheve ose mjetet e menaxhimit të projektit mund të përdoren për të lehtësuar komunikimin midis pjesëmarrësve, organizatorëve dhe palëve të interesuara të përfshirë në vizitën studimore.



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISes4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

Përpara vizitës studimore krijoni një listë për regjistrimin e pjesëmarrësve që do marrin pjesë, përdorimi i Excel-it mund të jetë i dobishëm ose edhe platforma të tjera online, si Teams etj. Sigurimi i këtij informacioni paraprakisht është i domosdoshëm, pasi lejon mbledhjen e detajeve thelbësore si numri i pjesëmarrësve, akomodimi i secilit pjesëmarrës, adresat e e-mailit dhe informacionet e kontaktit. Këto detaje janë thelbësore për kryerjen e aranzhimeve dhe organizimin efektiv të logjistikës së udhëtimit, duke siguruar koordinim dhe zbatim të suksesshëm të vizitave studimore.

Përdorni shërbime të ruajtjes së informacionit 'cloud based storage services' si Google Drive, Microsoft OneDrive ose Teams për të ndarë dokumentet kryesore, itineraret, hartat, udhëzuesit e udhëtimit, agjendën dhe informacione të tjera të rëndësishme me pjesëmarrësit. Kjo siguron që të gjithë të kenë akses në burimet e nevojshme dhe mund t'u referohen atyre sipas nevojës gjatë vizitës.

Gjetjet Kryesore dhe Rekomandimet

Bazuar në përshtypjet e mbledhura nga pyetësorët e vlerësimit, është evidente se pjesëmarrësit e rinj vlerësojnë lëvizshmërinë dhe njohuritë praktike të fituara gjatë përvojës së vizitave studimore. Pjesëmarrësit nënvizojnë rolin e vizitave në stimulimin e frymëzimit dhe të mësuarit nëpërmjet veprimit, të cilat lehtësojnë shkëmbimin e njohurive dhe nxisin iniciativën midis të rinjve, siç dëshmohet nga synimet e shprehura të shumë pjesëmarrësve për të ngritur ose zgjeruar sipërmarrje sociale.

Vizitat studimore në kuadër të projektit WISes4Youth kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në avancimin e të kuptuarit të sipërmarrjes sociale, duke treguar natyrën e saj të shumëanshme dhe potencialin për të shkaktuar përfitime pozitive në shoqëri. Prandaj, është e domosdoshme të zhvillohen më shumë aktivitete të kësaj natyre për të forcuar më tej mbështetjen për individët e rinj.

Kushtojini vëmendje planifikimit dhe aranzhimeve logjistike për të siguruar efikasitetin përgjatë vizitës studimore.

Përzgjidhni praktika të suksesshme dhe të mira të sipërmarrjeve sociale për vizitat studimore, duke siguruar diversitet ndërmjet sektorëve dhe shërbimeve të ofruara. Kjo përjasje ofron një gamë të gjerë shembujsh për t'u eksploruar, duke nxitur një mjedis mësues divers dhe gjithëpërfshirës gjatë vizitave.

Lehtësoni komunikimin dhe dialogun e strukturuar ndërmjet pjesëmarrësve dhe sipërmarrësve socialë për të nxitur një kuptim më gjithëpërfshirës, adresimin efektiv të pyetjeve dhe lehtësimin e bashkëpunimeve dhe partneriteteve të mundshme.



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

3.4. Paketa e Punës 4 (PP4): Zhvillimi i Trajnimeve

Partneri udhëheqës i PP4 : Shoqata Sillovene për Shëndetin Mendor – ŠENT, Slloveni

Periodha e zbatimit: Muaji 10 – Muaj 14 (Janar 2023 – Mars 2023)

Përmbledhje e PP4

PP4 synoi zhvillimin e aktivitete të strukturuar të trajnimit që përfshijnë partnerët e projektit dhe sipërmarrës të rinj potencialë, nëpërmjet aplikimit empirik të moduleve të trajnimit. Ky objektivi specifik u zbatua në të gjitha vendet e projektit për të mbledhur gjithashtu informacion në lidhje me ekosistemin e WISE-ve dhe sipërmarrjeve sociale në nivel kombëtar të secilit shtet të partnerëve. Të paktën 5 sipërmarrës të rinj potencialë ishin pjesëmarrës në trajnimet e secilit shtet partnerë. Janë realizuar gjithsej 5 programe trajnimi, nga një në secilin prej vendeve partnere të konsorciumit.

Paketa e punës konsistonte në **dy detyra kryesore**, e para lidhej me një sesion trajnimi njëjavor për partnerët ose trajnim për trajnerë mbi temën e ekonomisë sociale dhe impaktit social. Trajnimi u organizua në Slloveni nga ŠENT udhëheqësi i PP4. Ky trajnim i pajisi partnerët me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të administruar të dy modulet e trajnimit në vendet e tyre përkatëse dhe për të përcjellë këto njohuri te grupi i synuar. Detyra e dytë ishte një sesion trajnimi 5-ditor në secilin nga vendet përkatëse të partnerëve. Në këto trajnime u trajtuan të dy modulet, përkatësisht “Menaxhimi i impaktit duke kushtuar një vëmendje të veçantë ndaj grupeve vulnerabël” dhe “Menaxhimi i sipërmarrjeve sociale dhe WISEs”. Një pyetësor vlerësimi për trajnimet u plotësua nga pjesëmarrësit në sesionet e trajnimit dhe një raport mbi zhvillimin e trajnimeve u përgatit nga secili partner për trajnimet e mbajtura në vendet e tyre përkatëse. Këto raporte u konsoliduan në një raport përfundimtar, duke kombinuar rezultatet e përgjithshme dhe duke ofruar një pasqyrë të cilësisë së përgjithshme të trajnimit dhe vlerësimit nga pjesëmarrësit në të gjitha seancat.

Mjetet, Metodologjitë dhe Strategjitë

Më poshtë janë përshkruar mjetet dhe metodologjitë e përdorura për të zhvilluar në mënyrë efektive aktivitetet e trajnimit brenda projekteve. Këto njohuri vijnë nga rezultatet kryesore të PP4.

Merrni në konsideratë dhe përdorni ekspertizën e partnerëve të konsorciumit kur hartoni dhe planifikoni sesionet e trajnimit. Kjo përfshin identifikimin e njohurive dhe aftësive të



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISes4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

tyre të specializuara për të përshtatur përmbajtjen dhe metodologjinë e zhvillimit të trajnimeve përkatësisht, duke siguruar që seancat të jenë informuese dhe tërheqëse për pjesëmarrësit.

Gjithashtu është e rëndësishme të vlerësohet përmbajtja e kurrikulës së trajnimit dhe të vendoset në dispozicion një kohe e konsiderueshme për pjesëmarrësit për të kuptuar temat në tërësi. Sigurimi i kohës së mjaftueshme për diskutim, sqarim dhe zbatim praktik gjatë sesioneve të trajnimit u mundëson pjesëmarrësve të kuptojnë qartë kurrikulat.

Përcaktoni rolet e trajnerëve të ndryshëm bazuar në ekspertizën e tyre për të mbuluar tema të ndryshme brenda kurrikulës. Caktoni trajnerë me njohuri dhe aftësi të specializuara për të udhëhequr sesione mbi tema specifike, duke siguruar që pjesëmarrësit të marrin udhëzime gjithëpërfshirëse dhe të detajuara të përshtatura për secilën temë të trajtuar.

Vlerësoni trajnimin çdo ditë, në fillim të çdo dite dhe në fund të trajnimit për të marrë komentet dhe vlerësimet e pjesëmarrësve dhe përdorni ato për të përmirësuar më tej kurrikulën, udhëzimet e trajnimit dhe materialet sipas nevojave dhe pritshmërive të pjesëmarrësve.

Pjesëmarrësit që morën pjesë në sesionin 'trajnim për trajnerë' vinin nga eksperiencia të ndryshme dhe ishin të aftë të ofronin njohuri për pjesëmarrësit.

Inkurajoni pjesëmarrësit me eksperiencia të ndryshme të ndajnë njohuritë e tyre gjatë sesioneve të trajnimit. Kjo përfshirje nxit një mjedis mësimor bashkëpunues ku individët mund të kontribuojnë me perspektivat, përvojat dhe ekspertizën e tyre unike për të pasuruar diskutimet dhe për të përmirësuar përvojën e përgjithshme të të mësuarit.

Pas trajnimit, siguroni pjesëmarrësve të gjitha materialet dhe ekspertizën e duhur si në trajnimin për trajnerë ashtu edhe në trajnimin për të rinjtë.

Pas trajnimit, sigurohuni që pjesëmarrësit të marrin të gjitha materialet dhe ekspertizën e nevojshme. Kjo përfshin ofrimin e burimeve gjithëpërfshirëse, të tilla si manuale dhe materiale shtesë, si dhe mbështetje dhe udhëzime të vazhdueshme nga trajnerë me përvojë për të lehtësuar zbatimin efektiv të përmbajtjes së trajnimit.

Vlerësoni trajnimin zyrtarisht përmes regjistrimit të pjesëmarrësve, raporteve të vlerësimit dhe përgatitni raportet përfundimtare dhe pyetësorët e vlerësimit.



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

Kombinoni trajnimet me vizita studimore, të cilat gjatë zbatimit të WISEs4Youth kanë treguar se i përgatisin të rinjtë në mënyrë të konsiderueshme më mirë për të punuar dhe/ose themeluar WISE dhe sipërmarrje sociale.

Vlerësoni metodologjinë dhe kurrikulën e përdorur gjatë trajnimeve për të siguruar përshtatshmërinë dhe përputhshmërinë e tyre me standardet e BE-së. Megjithatë, është e domosdoshme rishikimi i kurrikulave për t'u siguruar që ato janë në përputhje me kornizat dhe zhvillimet në nivel kombëtar. Disa tema dhe materiale, të tilla si aspekti i menaxhimit, dhe kuadri ligjor mund të ndryshojnë ndjeshëm dhe kërkojnë përshtatje për të trajtuar në mënyrë efektive kontekste të veçanta kombëtare.

Ilustroni kurrikulën me shembuj praktikë për të lehtësuar kuptimin e informacionit nga pjesëmarrësit. Kjo përfshin përfshirjen e praktikave të botës reale, rasteve studimore dhe aktiviteteve praktike që demonstrojnë se si konceptet teorike mund të zbatohen në situata praktike.

Gjetjet Kryesore dhe Rekomandimet

Në përgjithësi, ka disa përfundime që mund të zbatohen për çdo trajnim të ardhshëm në çdo kontekst të BE-së:

- Bazuar në raportet e vlerësimit nga kurset pilot, është thelbësore që programet e trajnimit të përshtaten me nevojat dhe preferencat specifike të pjesëmarrësve në çdo vend. Kjo përfshin fokusimin më shumë në ushtrime praktike dhe shembuj të jetës reale, si dhe zgjerimin e moduleve mbi tema si financat dhe sipërmarrja sociale.
- Përfshirja e elementeve ndërvepruese në trajnim, ku pjesëmarrësit mund të ndajnë dhe diskutojnë idetë e tyre, mund të rrisë angazhimin dhe kuptimin e qartë të temave.
- Për më tepër, mbledhja e komenteve të detajuara nga pjesëmarrësit është thelbësore për përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së trajnimit dhe metodave të ofrimit të trajnimit.
- Theksoni mësimin praktik me aktivitete praktike, raste studimore dhe aplikime të botës reale. Integroni shembuj, ushtrime dhe detyra të shumta për të përforcuar konceptet teorike dhe për të lehtësuar të nxënit aktiv. Sigurohuni që konceptet teorike të jenë të kontekstualizuara me shembuj përkatës për të demonstruar rëndësinë dhe zbatueshmërinë praktike.



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

- Siguroni që trajnimet të jenë në cilësinë e duhur dhe të ruani nivelin aktual të cilësisë së trajnimit, duke siguruar që përmbajtja të jetë relevante, e saktë dhe tërheqëse për pjesëmarrësit.
- Konsideroni ofrimin e trajnimit në format modular për të përshtatur interesat dhe preferencat e ndryshme të pjesëmarrësve. Kjo i lejon individët të përqendrohen në fusha specifike të interesit dhe të marrin pjesë në module që lidhen me nevojat e tyre.

Trajnimi u ofron sipërmarrësve të rinj të gjitha njohuritë e nevojshme për të filluar sipërmarrjen e tyre sociale dhe për të minimizuar rrezikun me të cilin do të përballen kur të fillojnë karrierën e tyre. Megjithatë, ai nuk është mjaftueshëm gjithëpërfshirës për të qenë një alternativë ndaj çdo kuadri arsimor formal, por patjetër do t'u lejojë individëve që mund të kenë akses në shërbime të tjera përkatëse të kenë një shans më të mirë për sukses.

Duhet të ofrohen skema të financimit të sipërmarrjes rinore, pika informacioni, organe këshillimore, këshillime ligjore pro-bono dhe masa të tjera mbështetëse për të lehtësuar suksesin e sipërmarrësve të rinj në fillimin e sipërmarrjeve të tyre sociale. Inkurajimi i investimeve në WISE si një treg i rëndësishëm shoqëror për të rinjtë.

Siguroni përfshirjen aktive të pjesëmarrësve gjatë sesioneve të trajnimit duke përfshirë elemente ndërvepruese dhe aktivitete angazhuese që inkurajojnë pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin.

Zhvilloni pyetësorë vlerësimi për të vlerësuar efektivitetin e trajnimit, duke përfshirë pyetje të mbyllura dhe të hapura për të mbledhur vlerësime gjithëpërfshirëse. Përkthimi i pyetësorëve në gjuhën kombëtare të pjesëmarrësve mund të përmirësojë saktësinë dhe kuptimin e pyetjeve.

Sigurohuni që materialet e trajnimit të jenë të drejtpërdrejta dhe shmangni mbingarkimin e pjesëmarrësve me përmbajtje intensive. Kjo promovon aksesueshmërinë dhe rrit përvojën e përgjithshme të të mësuarit për pjesëmarrësit.

Përfshini tema praktike dhe të rëndësishme si financat, menaxhimi dhe matja e impaktit social dhe marketingu në trajnim. Përfshirja e temave jo-tradicionale, të avancuara, dhe me interes siguron që pjesëmarrësit të marrin një eksperiencë mësimore gjithëpërfshirëse dhe relevante.



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

Gjatë përgatitjes së sesioneve të trajnimit, është thelbësore që të përcaktohen qartë objektivat e trajnimit, agjenda dhe detaje të tjera përkatëse, duke krijuar qartësi dhe përafrim midis qëllimeve të pjesëmarrësve.

Inkurajoni pjesëmarrjen aktive dhe bashkëpunimin ndërmjet pjesëmarrësve në trajnime. Interaktiviteti në trajnim është thelbësor, ku pjesëmarrësit ndajnë dhe diskutojnë idetë e tyre dhe punën praktike me njëri-tjetrin dhe me trajnerët.

3.5. Paketa e Punës 5 (PP5): Evente të të Mësuarit në Bashkëpunim

Partneri udhëheqës i PP5 : Instituti për Zhvillim të Bashkësisë – CDI, Maqedonia e Veriut

Periudha e Zbatimit: Planifikuar për M10 -M14, zbatuar (Mars 2023 – Maj 2023)

Përmbledhje e PP5

Qëllimi i PP5 “Peer Learning Events” ose Evente të të Mësuarit në Bashkëpunim², ishte forcimi i krijimit të WISE-ve rajonale dhe rrjeteve të sipërmarrjeve sociale në rajon, promovimi i impaktit social të këtyre bizneseve dhe ndër të tjera zhvillimi i përbashkët dhe përfshirja e të rinjve, si dhe mbështetja e dialogut social dhe etnik ndërmjet vendet e ndryshme.

Brenda kësaj PP, **aktivitetet kryesore** ishin përgatitja e eventeve të të mësuarit në bashkëpunim mes kolegësh për forcimin e praktikës të të mësuarit në bashkëpunim rreth një zone të caktuar, midis një grupi të synuar specifik, mbi temat e përzgjedhura. Ndërkohë, aktiviteti i dytë konsistonte në **zhvillimin e eventit “peer to peer learning”** bazuar në metodologjinë e përgatitur më parë.

Rezultatet kryesore të kësaj PP janë zhvillimi i Udhëzuesit për të mësuarit në bashkëpunim midis kolegësh - dokument 21 faqesh në gjuhën angleze, drejtuar atyre që janë të përfshirë në organizimin e trajnimeve ose ‘workshop-eve’ në nivel projekti ose në nivel vendi, me një qëllim të përgjithshëm shkëmbimin e informacionit dhe të mësuarit nga njëri tjetri. Dhe, **Raporti i Vlerësimit** të eventit online “peer learning” organizuar në kuadër të këtij projekti – dokument 15 faqesh në gjuhën angleze që synon të ndihmojë në

² ‘Evente të të Mësuarit në Bashkëpunim’ në dokument janë të shprehura edhe si : ‘Peer learning events’; evente ‘peer learning’; dhe evente ‘peer to peer learning’.



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

përmirësimin e aktiviteteve të tilla duke mbledhur eksperiencë dhe sugjerime nga pjesëmarrësit.

Mjetet, Metodologjitë dhe Strategjitë

Më poshtë shpjegohen metodologjitë dhe mjetet e përdorura për të zhvilluar evente të suksesshme “peer to peer learning” duke u mbështetur në aktivitetet kryesore dhe rezultatet e PP5 në kuadër të projektit WISEs4Youth.

1. Zhvillimi i një Udhëzuesi për “Peer to Peer learning”

Qëllimi i udhëzuesit është të mbështesë planifikimin dhe organizimin e ardhshëm të eventeve të ngjashme në vende ose kontekste të tjera. Ky udhëzues prezanton disa nga vendimet që duhen marrë dhe planifikimet që duhen bërë për të realizuar një event të suksesshëm “peer learning”. Udhëzuesi shërben si një burim gjithëpërfshirës që përshkruan objektivat, formatin dhe rezultatet e pritura të eventit “peer learning”. Ky udhëzues paraqet parimet e “peer learning” qëllimin dhe objektivat, si dhe ofron sugjerime se si të vlerësohet nevoja për organizimin e një eventi të tillë, procesi i përgatitjes, metodologjitë për lehtësimin, kohëzgjatja dhe vlerësimi i përgjithshëm. Nevoja për përgatitjen e udhëzuesve lind nga njohja e rëndësisë së shkëmbimit të praktikave të mira dhe mundësitë të të mësuarit të ndërsjelltë ‘cross-learning’ midis vendeve.

Këtu janë disa mjete dhe metodologji për t'u marrë në konsideratë:

Sesione bashkëpunuese ‘brainstorming’ midis partnerëve të projektit për të përcaktuar objektivat, formatin dhe rezultatet e pritshme. Është thelbësore që dokumenti përfundimtar i përgatitur nga udhëheqësi i i PP5 t'i nënshtrohet vlerësimit dhe miratimit nga të gjithë partnerët e përfshirë.

Ndarja e dokumentit në proces pune me partnerët nëpërmjet platformave të bashkëpunimit – Teams ku lehtësohet redaktimi dhe komentimi në kohë reale, duke siguruar kontributin efektiv nga të gjithë partnerët.

Eksperiencë e partnerëve në organizimin e aktiviteteve të tilla dhe konsultimi me aktorët përkatës janë një nga burimet kryesore që duhet përdorur.

2. Identifikimi i aktorëve të interesit dhe folësve

Identifikimi i aktorëve dhe folësve përfshin identifikimin dhe kategorizimin e individëve, organizatave ose subjekteve që kanë një interes ose ekspertizë të lidhur me temën e aktivitetit ose projektit. Kjo mundëson një gamë të larmishme këndvështrimesh dhe



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

ekspertize të përfaqësuar në këtë event. Më poshtë janë metodologjitë dhe qasjet për të identifikuar në mënyrë efektive palët e interesit dhe folësit.

Gjatë organizimit të seancave ‘peer to peer learning’ që përfshijnë kolegë nga vende të ndryshme, bashkëpunimi me partnerët e konsorciumit është shumë i rëndësishëm për të identifikuar aktorët e interesit për t'i përfshirë në takim. Përqasja dhe bashkëpunimi me institucionet qeveritare, organizatat joqeveritare dhe palët e tjera të interesuara është thelbësore.

Është e rëndësishme të kuptohet nevoja për ti angazhuar dhe përfshirë aktorët kryesorë që në fazat e para të organizimit të takimit dhe njëkohësisht të ftohen si folës, kjo metodë ofron perspektiva të ndryshme dhe pasuron eksperiencën e të mësuarit.

Kontakti i drejtpërdrejtë me aktorët e interesuar bazuar në rëndësinë dhe kontributin e mundshëm të secilit prej tyre, është gjithashtu një element i rëndësishëm për organizimin e suksesshëm të eventeve ‘peer to peer learning’.

3. Përzgjedhja e temave të diskutimit për eventin

Përzgjedhja e temave të **diskutimit** për një “peer learning event” përfshin një qasje të menduar dhe sistematike që merr parasysh nevojat e audiencës, tendencat aktuale, ekspertizën, diversitetin, objektivat e të mësuarit dhe realizueshmërinë. Këtu janë disa mjete dhe metodologji për t'u marrë parasysh:

Përzgjedhja e temave përmes konsultimit me përfaqësues të sipërmarrjeve sociale, institucioneve qeveritare dhe ekipit të projektit. Kjo përfshin identifikimin e çështjeve urgjente dhe përcaktimin e zgjidhjeve efektive.

Seancat ‘brainstorming’, konsultimet e drejtpërdrejta, takimet online, mbledhja e të dhënave dhe prioritizimi i temave janë mjete të vlefshme për identifikimin e temave përkatëse. Këto metoda mundësojnë mbledhjen e të dhënave, bashkëpunimin në distancë dhe vlerësimin sistematik të temave të mundshme për të siguruar përputhjen me objektivat e eventit.

Përfshirja e aktorëve përkatës të interesit siguron përafrimin me nevojat e audiencës, duke rritur rëndësinë dhe impaktin e diskutimit.

Merrni në konsideratë studimet dhe konsultimet e mëparshme që theksojnë rëndësinë e adresimit të çështjeve urgjente. Duke përfshirë gjithashtu edhe një analizë të literaturës për temën e specifikuar (sipërmarrja sociale dhe WISEs në rastin tonë), sfidat dhe



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISes4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

praktikat më të mira si dhe shkëmbimi i praktikave të mira nga eksperiencia e folësve dhe pjesëmarrësve potencialë.

4. Përzgjedhja e pjesëmarrësve përmes një procesi të hapur dhe transparent

Përzgjedhja e pjesëmarrësve përmes një procesi të hapur dhe transparent përfshin vendosjen e kriterëve të qarta, shpalljen publike të mundësive, sigurimin e mundësive të barabarta, kryerjen e vlerësimeve transparente dhe kthimin e përgjigjeve për pyetjet e aplikantëve. Kjo përjasje promovon drejtësinë, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në përzgjedhjen e pjesëmarrësve. Një proces përzgjedhjeje i hapur dhe transparent siguron pjesëmarrjen e individëve me njohuri dhe përvojë përkatëse. Më poshtë disa nga metodat, mjetet dhe qasjet për procese të hapura dhe transparente në përzgjedhjen e pjesëmarrësve:

Është e rëndësishme të kuptohet nevoja për transparencë dhe të hartohet një proces i hapur dhe transparent përzgjedhjeje, duke përdorur pyetësorë për të vlerësuar përshtatshmërinë e kandidatëve me temën dhe qëllimin e eventit.

Platforma online (Google Forms mund të përdoret për të mbledhur dhe vlerësuar aplikimet e pjesëmarrësve. Përgatitni pyetësorë për të vlerësuar kandidatët bazuar në ekspertizën dhe përshtatshmërinë e tyre për eventin.

Përzgjedhja e strukturuar siguron një grup të larmishëm dhe të kualifikuar pjesëmarrësish, duke inkurajuar diskutime të pasura dhe shkëmbim njohurish.

5. Eventet “Peer Learning”

Eventet “Peer Learning” janë takime bashkëpunuese ku pjesëmarrësit ndajnë njohuritë, aftësitë dhe eksperiencat e tyre me njëri-tjetrin. Ato zakonisht përfshijnë diskutime joformale, workshop-e, aktivitete në grup, mundësi rrjetëzimi dhe sesione të ndryshme për të lehtësuar të mësuarit dhe zhvillimin e aftësive në një mjedis mbështetës dhe bashkëpunues. Organizimi i eventeve “peer learning” bazuar në metodologjinë e zhvilluar dhe udhëzuesit e përgatitur është thelbësor për një event të suksesshëm, më poshtë paraqiten disa mjete dhe metoda për të zhvilluar në mënyrë efektive aktivitete të tilla:

Përdorimi i udhëzuesve për “peer learning events” dhe adaptimi i tyre për t’iu përshtatur rrethanave aktuale është thelbësorë për të maksimizuar eksperiencën e të mësuarit. Përmbajtja dhe metodat e përshkruara në udhëzues duhet të adaptohen për t’iu përshtatur



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

nevojave dhe sfidave specifike të situatës aktuale, duke siguruar që temat e trajtuara janë të vlefshme dhe efektive.

Konsultimi me ekipin e projektit është thelbësor për suksesin e aktivitetit, duke përfshirë ndarjen e ideve dhe komenteve për të siguruar përafrimin me objektivat dhe strategjitë dhe për të nxitur një vendimmarrje dhe koordinim bashkëpunues.

Përgatitja dhe ndarja në kohë me folësit dhe pjesëmarrësit e të gjitha materialeve përkatëse, si përshkrimi i eventit, agjenda, temat kryesore që do të diskutohen etj.

Krijoni biblioteka ose burime informacioni online ku pjesëmarrësit mund të kenë akses në materialet, artikujt, videot dhe mjetet përkatëse para, gjatë dhe pas aktivitetit për të plotësuar përvojën e tyre e të mësuarit.

Përzgjedhja e formës apo platformës së duhur për eventin, për shembull organizimi i eventit përmes platformës Online – si ZOOM, lejon fleksibilitetin për pjesëmarrje veçanërisht për eventet që përfshijnë vende të ndryshme.

Bashkëpunim i ngushtë me ekipin e projektit dhe folësit në aktivitet.

Vendosni në dispozicion kohë për sesionet e rrjetëzimit, diskutimet në grupe nëpërmjet 'breakout rooms' ose pushimet virtuale të kafesë ku pjesëmarrësit mund të komunikojnë, të ndajnë përvoja dhe të ndërtojnë marrëdhënie me njëri-tjetrin.

Përcaktoni lehtësues të aftë për të udhëhequr diskutimet në grup, për të moderuar seancat dhe për të siguruar që bisedat të qëndrojnë të fokusuar, produktive dhe gjithëpërfshirëse.

Krijoni mekanizma feedback-u i si pyetësorët, sondazhet ose 'focus groups' për të mbledhur të dhëna nga pjesëmarrësit mbi preferencat e tyre të të mësuarit, interesat dhe vlerësimin për eventin.

Duke ndjekur strukturën dhe temën e Peer Learning organizuar në kuadër të projektit WISEs4Youth, gjeni më poshtë detajet:

Eventi u strukturua në 3 sesione kryesore:

- **Diskutim në panel** me 7 folës dhe panelistë nga 5 vende të ndryshme, të cilët janë ekspertë në fushat e tyre dhe kanë eksperiencë praktike në punën në sipërmarrjen sociale dhe masat mbështetëse përkatëse.



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

* Tema: Roli i WISE-ve në ekonominë lokale dhe kombëtare

- **Diskutim në grupe nëpërmjet “Break out Room session”** ku pjesëmarrësit u ndanë në 3 grupe dhe patën mundësinë të diskutojnë rreth sfidave me të cilat përballen WISE-të gjatë rritjes dhe zhvillimit të tyre, të ofrojnë rekomandimet dhe të diskutojnë mbi mundësitë për krijimin e partneriteteve të qëndrueshme me aktorët e tjerë të interesuar.

* Temat për diskutim: Cilat janë disa nga sfidat me të cilat përballen WISE-të për sa i përket rritjes dhe zhvillimit? Si mund të trajtohen këto sfida? Si mund të krijojnë WISE-të partneritete të qëndrueshme me aktorë të tjerë të interesuar?

- **Ndarja e rezultateve** nga diskutimet në grup dhe diskutimet e mëtejshme me të gjithë pjesëmarrësit.

6. Vlerësimi

Vlerësimi i eventit “peer learning” nga pjesëmarrësit përfshin vlerësimin e efektivitetit të eventit, kënaqësinë e pjesëmarrësve dhe arritjen e objektivave të të mësuarit. Vlerësimi i eventit është i rëndësishëm pasi ofron njohuri të vlefshme për impaktin e eventit, identifikon fushat për përmirësim dhe informon planifikimin dhe vendimmarrjen e ardhshme.

Për vlerësimin e aktivitetit në kuadër të projektit WISEs4Youth janë përdorur dy lloje të formularëve të vlerësimit që mund të konsiderohen për vlerësim të aktiviteteve të këtij lloji:

1. *Një pyetësor online i kombinuar (me alternativa zgjedhje dhe pyetje të hapura).*

Pyetësori i vlerësimit online u përgatit për të mbledhur komente nga pjesëmarrësit në lidhje me efektivitetin e aktivitetit, rëndësinë e përmbajtjes dhe eksperiencën e përgjithshme. Kjo mundëson përmirësimin e vazhdueshëm të eventeve të ardhshme “peer learning” .

* Pyetësori u strukturua si më poshtë:

- 2 pyetje mbi detajet e pjesëmarrësve: nga cili vend janë dhe cilin sektor përfaqësojnë.

- 5 pyetje me alternativa zgjedhje: Si e vlerësoni takimin për sa i përket cilësisë së përgatitjes dhe organizimit? Struktura dhe përmbajtja e takimit (p.sh. objektivat, aktivitetet, përgjegjësitë, etj.) Ndërveprimi ndërmjet palëve të interesuara brenda takimit ishte:.....; A



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

mendoni se i kemi arritur qëllimet e përshkruara në agjendën e takimit? Sa do të jenë të dobishme njohuritë që keni mësuar gjatë takimit për rutinën tuaj të përditshme të punës?

- 4 pyetje të hapura : Kontributi im në një takim të suksesshëm ishte....; Cila pjesë e takimit ju duk veçanërisht e rëndësishme dhe motivuese, personalisht dhe profesionalisht? A përputhej seanca me pritshmëritë tuaja? Çfarë funksionoi veçanërisht mirë gjatë takimit? Sipas jush, çfarë mund të përmirësohet/ ndonjë koment? Në çfarë mënyrash të tjera mund të mbështesin takimet tona zhvillimin dhe rritjen tuaj profesionale?

2. Zhvillimi i intervistave individuale

Intervistat u drejtuan sipas pyetjeve të pyetësorit online, por me një fokus më të madh në përvojën e përgjithshme para dhe gjatë eventit si dhe në komentet/rekomandimet e tyre për përmirësim. Qëllimi ishte të grumbullohej më shumë informacion për përvojat e tyre, sfidat me të cilat ata u përballën gjatë takimit dhe sugjerimet e tyre për përmirësim. Këto intervista siguruan të dhëna cilësore për të plotësuar komentet sasiore të mbledhura përmes pyetësorit të vlerësimit online.

Gjetjet Kryesore dhe Rekomandimet

- *Gjetjet kryesore nga procesi i zbatimit*

Zbatimi i suksesshëm i eventit u realizua nëpërmjet një bashkëpunim efektiv, pasi seancat bashkëpunuese 'brainstorming' mundësuan zhvillimin e një udhëzuesi 'peer learning' gjithëpërfshirës, duke siguruar përafrimin e qëllimeve dhe rezultateve midis partnerëve të projektit.

Angazhimi i aktorëve të interesuar luan një rol kyç, identifikimi i këtyre aktorëve dhe ftesa e tyre për të qenë folës në aktivitet, pasuron eksperiencën e të mësuarit duke ofruar këndvështrime dhe ekspertizë të ndryshme.

Gjithashtu, përzgjedhja e temave me rëndësi u mundësua përmes konsultimit me aktorët e interesuar, të cilët i përafrian diskutimet e tyre në aktivitet me nevojat e audiencës, duke rritur impaktin e diskutimeve.

Proceset transparente të përzgjedhjes së pjesëmarrësve sollën një grup të larmishëm dhe të kualifikuar, duke inkurajuar diskutime të pasura dhe shkëmbim njohurish.



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

Së fundi, zhvillimi i suksesshëm i aktivitetit iu atribuua bashkëpunimit të ngushtë me ekipin e projektit dhe respektimit të udhëzuesit të zhvilluar, duke mundësuar një eksperiencë të mirë online të “peer learning event”.

- *Arritjet, sfidat dhe mësimet e nxjerra*

Arritjet e projektit përfshijnë përgatitjen e një Udhëzuesi ‘Peer to Peer Learning’ gjithëpërfshirës, i cili shërben si një udhëzues i vlefshëm për organizimin e eventeve të ngjashme, së bashku me identifikimin e suksesshëm të aktorëve të interesuar dhe folësve, duke siguruar një përfaqësim të larmishëm. Përveç kësaj, përzgjedhja e temave përkatëse bazuar në konsultimin me aktorët e interesuar mundësoi trajtimin në mënyrë efektive të çështjeve aktuale me të cilat përballen WISE. Procesi transparent i përzgjedhjes së pjesëmarrësve solli një grup të larmishëm dhe të angazhuar pjesëmarrësish, gjë që kontribuoi në diskutime të pasura. Për më tepër, zhvillimi i suksesshëm i eventit online “peer to peer learning” kishte pjesëmarrje aktive dhe u vlerësua pozitivisht nga të pranishmit. Sfidat e hasura përfshijnë sigurimin e angazhimit aktiv të aktorëve të interesuara, përshtatjen e metodologjive në kontekste të ndryshme kulturore dhe menaxhimin e vështirësive logjistike që lidhen me organizimin e eventeve online. Mësimet e nxjerra theksuan rëndësinë e përfshirjes së hershme të aktorëve të interesuar, fleksibilitetin në përshtatjen e metodologjisë, komunikimin efektiv midis partnerëve dhe përmirësimin e vazhdueshëm përmes integritit të komenteve dhe rekomandimeve në eventet e ardhshme dhe rezultatet e projektit.

- *Elementet për tu pasur në konsideratë përsa i përket përshtatjes në aspektet kulturore*

Në konsiderimin e faktorëve kulturorë, është thelbësore të respektohet diversiteti dhe ndjeshmëria ndaj zakoneve dhe traditave lokale, duke kuptuar stilet dhe preferencat e ndryshme të komunikimit në kultura të ndryshme. Adaptimi duhet të përfshijë përshtatjen e përmbajtjes dhe përjasjeve për t'u përafuar me normat dhe vlerat kulturore lokale, duke siguruar vlefshmërinë e aktivitetit dhe përfshirjen e pjesëmarrësve. Përveç kësaj, ofrimi i përkthimeve në gjuhët e tyre kombëtare dhe materialeve në kontekstin lokal është thelbësor për përmirësimin e aksesit dhe promovimin e përfshirjes në kontekste të ndryshme kulturore.

- *Rekomandime dhe përfundime*

Për aktorët e ekonomisë sociale dhe WISE-të, është e domosdoshme t'i jepet përparësi angazhimit dhe bashkëpunimit gjatë gjithë ciklit jetësor të projektit, dhe zhvillimit të



Co-funded by
the European Union



Projekti: 101049682 — WISEs4Youth — ERASMUS-YOUTH-2021-PCOOP-ENGO

aktiviteteve duke përshtatur metodologjitë dhe mjetet në kontekstin lokal për të siguruar përfshirje dhe vlefshmërinë e produkteve apo aktiviteteve të realizuara.

Theksimi i transparencës në proceset e përzgjedhjes së pjesëmarrësve inkurajon pjesëmarrjen e larmishme dhe të angazhuar, ndërsa mbledhja e vazhdueshme e komenteve mundëson përmirësimin të vazhdueshëm, rritjen e efektivitetit të projektit, dhe organizimin e eventeve të suksesshme “peer to peer learning”.

